



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:047217

Datë: 31.01.2020

Numri i dokumentit: 00801372

**P.nr.104/2018**

**GJYKATA THEMELORE-Departamenti për Krime te Renda ne Pejë** , kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Sylë Lokaj , me pjesëmarrjen e Procesmbajtëses Binake Mulliqi, e sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore – Departamenti i përgjithshëm të përfaqësuar nga Prokurori i shtetit në Departamentin për Krime te Renda ne Pejë, PP.nr.1296/2018 dt.10.08.2018 e ka akuzua të akuzuarin A. B.për veprë penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPK-së dhe veprë penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPK-së duke vendosur sipas detyrës zyrtare jashtë shqyrtimit gjyqësorë , me dt.**30.01.2020** mur këtë :

**A K T V E N D I M**

Kundër te akuzuarit:

1. **A. B.**i biri i Xh. dhe H. e gjinisë A., i lindur me ..... ne fshatin ..... K..... ku edhe tani jeton në rr. “ ..... “ka ID ..... , ka të kryer shkollën e mesme, me profesion elektrikistë, ka qenë në mardhënje pune në ..... Distrikti ....., tani i pa punë, i gjendjes sedobët ekonomike ,shqiptar Shtetas i Republikës se Kosovës, i pa gjykuar me parë , gjendet ne liri.

**Ne kuptim te nenit 292 te KPPK-së.**

**HUDHET** , aktakuza e Prokurorit te shtetit departamenti i përgjithshëm PP.nr.1296/2018 dt.10.08.2018 me te cilën i akuzuari është akuzua për veprë penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPK-së dhe veprë penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPK-së dhe **PUSHOHET** , procedura penale.

**-për shkak se Prokurori i shtetit ka heq dorë nga ndjekja penale,**

Shpenzimet e procedurës penale , ju ngarkohen mjeteve buxhetore te kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore – Departamenti i përgjithshëm në Pejë, me aktakuzën, PP.nr.1296/2018 dt.10.08.2018 e ka akuzua të akuzuarin A. B. për veprë penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPK-së dhe veprë penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPK-së dhe lënda ka marr numrin në gjykatën Themelore dega në Istog P.nr. 268/2018, e cila është shpall inkompetente lëndore, e lënda është pranua dhe regjistruar në këtë gjykatë, në departamentin e krimeve të rënda, që ka marrë numrin DKR.P.nr.104/2018

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të rënda në Pejë, me aktakuzën PP.nr.130/2019 dt.22.02.2019 e ka akuzua të akuzuarin A. B., për vepra të njëjta penale, për vepër penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPK-së dhe vepër penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPK-së e lënda ka marrë numrin DKR.nr.19/2019 .

Prokurori i shtetit Haxhi Sinanaj jashtë shqyrtimit , me dt. 30..01.2020 ka deklarua se ndaj të akuzuarit gabimishtë janë ngritë dy aktakuza për vepra të njëjta penale, në fakt me që sipas aktakuzës PP.nr.130/2019 dt.22.02.2019 kundër të akuzuarit A. B., për vepra të njëjta penale, për vepër penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPK-së dhe vepër penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPK-së e lënda ka marrë numrin DKR.nr.19/2019 është mbajtë shqyrtimit kryesorë e me dt. 22.01.2020 është shpallë Aktgjykimi DKR.P.nr 19/2019 me të cilin i akuzuari është shpallë fajtor dhe penalisht përgjegjës për vepër penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-së dhe vepër penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-së andaj e tërheq aktakuzën e Prokurorisë Themelore – Departamenti i përgjithshëm në Pejë,PP.nr.1296/2018 dt.10.08.2018 kundër të akuzuarit A. B..

Kryetari i Trupit Gjykes pas shqyrtimit të kërkesës e sipas detyrës zyrtare , jashtë shqyrtimit gjyqësor, me që Prokurori i Shtetit ka hjek dorë nga ndjekja penale para se të fillon shqyrtimi, ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 292 te KPPK-së.

Vendimi qe shpenzimet e procedurës penale tu ngarkohen mjeteve buxhetore te kësaj gjykate është i bazuar ne nenin 454 par.1 te KPPK-së.

**U VENDOSE NE GJYKATEN THEMELORE – Departamenti për krime te Renda ne Pejë, me dt.30.01.2020  
P.nr.104/2018**

**Procesmbajtësja**  
Binake Mulliqi

**Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari**  
Sylë Lokaj

**UDHZIM JURIDIK**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 5 ditësh Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate .